

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 04.02.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, ne mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.01.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Ve Mor shpk" për aktivitetin: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-025-211 nxjerr:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Ve Mor" e datës 30.01.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik" me Nr. 616 18 440 211 Nr. Brendshëm : 616 -18-025-211 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 25.01.2019 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 25.01.2019 .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "**Ve Mor**" me datë 30.01.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" me numër të prokurimit Nr. 616 18 440 211 dhe numër të brendshëm 616 18 025 211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.02.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Lidhur me pretendimin se ju keni plotësuar kërkesat e pikës 9.1 dhe 9.2 të FDT-së dhe të pikës 3 të Aneksit 7 ju sqarojmë se ju keni dorëzuar tender për mirëmbajtje të rrugëve rurale dhe rrugëve të qytetit në Autoritetin e Njëte Kontraktues dhe është logjike se njëkohësisht pajisjet e njëjta nuk mund të përdoren në të dy projektet pasi që nevoja për mirëmbajtje është njëkohësisht në të dyja. Arsytimi juaj se ju keni kontraktuar makineri me të sotifikuara për rrugët rurale nuk është deshmuar me marrveshje valide.

Lidhur me arsytimin se nuk ju kemi paralajmëruar me kohë për vizite ju sqarojmë se është e drejtë e AK që të inspektoj pajisjet e CDO Operatori për të cilat janë dorëzuar deshmi të dyshimta sikurse në rastin tuaj. Nga vizita e personave të autorizuar është konstatuar se ato pajisje nuk janë funksionale dhe këtu nuk është vetëm një problem që ju e cekni - mungesa e baterive pasi që ato mund të vendosen lehtë për të funksionalizuar por konstatimi i komisionit është se shumica e atyre mjeteve vetëm janë shpërndarë nëpër pronën tuaj dhe shumica prej tyre si duket nuk janë funksionalizuar asnjëherë. Ky konstatim ka të bëjë me pajisjet për largim të bores, frezat dhe autocisternat. Për ilustrim u'ua perkujtojmë se në autoparkun tuaj janë gjetur vetëm dy autocisterna me regjistrime të jashtme dhe sipas gjendjes së tyre momentale duken si të pa funksionalizuara asnjëherë.

Bazuar në sqarimet paraprake ju sqarojmë se edhe në bazë të dokumentacionit edhe sipas inspektimit në terren rezulton se ju nuk i keni plotësuar kërkesat e pajisjeve për dy aktivitetet e lartcekura.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit